



**YLLI POLOVINA**

**DY DASHURI NË KOHËN  
E SOCIALIZMIT**

2020

## **Lënda e librit**

<b>Të internuar.....</b>	<b>5</b>
<b>Secila dashuri në fatin e saj.....</b>	<b>7</b>
<b>Fejesë e shumëdëshiruar, por e papritur.....</b>	<b>9</b>
<b>Pranverë sovjetike në Tiranë.....</b>	<b>12</b>
<b>Festivali i Rinisë në Moskë.....</b>	<b>14</b>
<b>Vallzim në Hotel Kolombo.....</b>	<b>17</b>
<b>Pasardhëse e Dëshmorit të Kombit.....</b>	<b>19</b>
<b>Kushëri i parë me Nexhmije Hoxhën.....</b>	<b>21</b>
<b>Puthje në Paris.....</b>	<b>25</b>
<b>Netët e Bardha në Shën Petersburg.....</b>	<b>27</b>
<b>Vjosa Jakova.....</b>	<b>28</b>
<b>Mita, Tuku, diktatori.....</b>	<b>29</b>
<b>24 maji, ditëdashuria e shndërruar</b>	
<b>në ditë fatkeqësie.....</b>	<b>32</b>
<b>“Xhan i Mitas!”.....</b>	<b>36</b>
<b>Ta jap fjalën Tuk.....</b>	<b>37</b>
<b>Vetëm sa përkëdhelën duart e njëri-tjetrit.....</b>	<b>41</b>
<b>Shpirti që e vranë.....</b>	<b>42</b>
<b>“Gjithë jetën të kam dashur për karakterin tënd”..</b>	<b>46</b>
<b>Elektroshok.....</b>	<b>50</b>
<b>Goditja e katërt.....</b>	<b>51</b>
<b>“Ku të të fsheh që të mos të gjejë vdekja?”.....</b>	<b>52</b>
<b>Zonjë e nderuar.....</b>	<b>53</b>
<b>Ringjallja.....</b>	<b>55</b>

Pothuaj të gjitha ngjarjet që do të përshkruhen në këtë libër të shkurtër me format elektronik e kanë sfondin e tyre kryesor në historinë e Shqipërisë së Luftës së Dytë Botërore si edhe në dramën politike të saj më pas, kur u shndërrua në diktaturë.

Por edhe në një qytet tepër të veçantë dhe të hapur ndaj lirisë së shpirtit: Beratin.

Është filli i dashurisë së zemrave brenda një sistemi politik të vrazhdë që do t'i mbajë të lidhura ato si edhe vetë njerëzit të cilët do të jenë personazhet kryesorë: festivalistja e rinisë në Moskë dhe mësuesja e talentuar e gjuhës ruse në atdhe, Hatixhe Gjebrea, bashkë me shokun e saj të jetës, kirurgun dibran Luan Greva; Mita, bashkëshortja e Tuk Jakovës, po ashtu vajza e tyre me bukuri dhe inteligjencë mahnitëse, Vjosa.

Si edhe shumë të tjerë, pa munguar në periferi edhe vetë Enver Hoxha me Nexhmijen e tij.

## Të internuar

Dihet që Berati është i vetmi qytet në tokat e shqiptarëve, por edhe për qindra kilometra përtej tyre, i cili në gojëdhënë e vet të formimit ka një histori dashurore. Ishte një vajze e bukur që u hyri në zemër njëherësh dy djemve.

Për t'ia fituar atë, ata bënë duel.

Njëri e godiste shemrin me topuz dhe tjetri i kthehej me shpatë.

Por vasha e hijshme nuk e dëshironte këtë dyluftim, prandaj u lutej të ndaleshin dhe me që ata kokëfortësisht e vazhduan ndeshjen me armë, ajo nisi të derdhte lotë e të qante pa pushim.

Kur u pa se dy të rinjtë nuk i ndalte asgjë dhe ndërkaq dhimbja e vajzës shumë të bukur u bë aq e madhe sa u përhap në të gjithë kozmosin, një fuqi hyjnore i ndali me mjetin e vetëm që kishte për ta zgjidhur: i ngriu që të tre.

Kështu vashëza u bë Kalaja (kodra qendrore e qytetit ku ndodhet kështjella dhe lagjia karakteristike e shtëpive një mbi një, Mangalemi).

Njëri djalë u shndërrua në Malin e Tomorit me shkëmbinjtë e thërrmuar prej topuzit të djaloshit Shpirag dhe ky i fundit, ngurtësuar edhe ai në mal, trupin e ka tashmë vija-vija pikërisht nga goditjet e shpatës së Tomorit.

Prej lotëve të vajzës Kala u formua lumi Osum, i cili kalon përmes banesave dhe kodrave në të majtë e në të djathtë, duke rendur pastaj drejt bashkimit me Devollin dhe më pas, nën emrin Seman, të derdhet në det.

Që Berati është qyteti shqiptar i dashurisë, përveç kësaj legjende, nuk e dëshmojnë edhe shumica e këngëve të tij popullore, lirika të ndjera po aq sa ato të korçarëve, por edhe një cilësi tjetër: pasioni i madh i beratasve për të rritur lule, sidomos trëndafila.

Nëpër oborre dhe parvaze dritaresh.

Pasion karakteristik që duket më i zbehur pas vitit nëntëdhjetë, kur pak nga pak qytetarët e vjetër u shvendosën masivisht në mërgim apo qytete të tjera të vendit, Tiranë e Durrës kryesisht.

Tamam në këtë mjedis në 23 qershor 1955 u transferuan nga Tirana familjarisht, në gjendje izolimi politik, bashkëshortët Dhimitra dhe Tuk Jakova.

Ky i fundit për të paktën tetëmbëdhjetë vite që një nga komunistët vendas më të njohur.

I burgosur dhe e internuar prej Ahmet Zogut.

Para se për herë të dytë ta dënonte Enver Hoxha që eksponent kryesor i Partisë Komuniste Shqiptare.

Tek erdhën në Berat çifti Jakova kishte me vete katër fëmijë.

Qenë fare të vegjël, nga 9 deri 4 vjeç.

Tuku menjëherë filloi të punonte si marangoz në zdrukthëtarinë shtetërore të qytetit, çfarë ishte zanat i viteve të tij të rinisë, kurse e shoqja si arsimtare në një shkollë fillore.

Në nëntor 1956 u njoftuan se qenë të internuar për pesë vite.

Në 24 maj 1957 Tuk Jakovën e ndanë nga familja dhe e mbyllën në Kalanë e Kaninës në Vlorë.

Në shtator e kyçën në Zvërnec.

Në 4 janar 1958 e arrestuan, ndërsa në 17 prill iu dha dënimi me 20 vite burg.

Që prej këtij çasti u mbajt në një qeli të asaj ngrehine që në Tiranë quhet Burgu i Vjetër.

## **Secila dashuri në fatin e saj**

Ndërkohë në vjeshtë të vitit 1958 nga kryeqyteti erdhi në Berat edhe një student që sapo pati përfunduar studimet në Fakultetin e Mjekësisë: Luan Greva.

Ishte emëruar mjek në regjimentin e artilerisë. Ky ndodhej në periferinë lindore të qytetit, në vendin e quajtur Uznovë, ngjitur me spitalin civil.

Kjo rrethanë e fundit do t'i jepte mundësi jo vetëm të rritej profesionalisht, por edhe të njihte nga shumë afër mijëra qytetarë vendas dhe banorë të fshatrave përreth.

Mjeku i porsaardhur, tip punëtor dhe shumë kurioz, e gjeti popullatën me një gjendje shëndetshmërie të mirë dhe të qëndrueshme, çfarë më së shumti qe rrjedhojë jo vetëm e gjysmës së dytë të viteve pesëdhjetë, kohë që mbahet mend për një lloj bollëku, por mbi të gjitha e traditës së jetës së zhvilluar dhe të begatë qytetare të Beratit që prej shumë shekujsh, sidomos në mijëvjeçarin e dytë.

Luan Greva që në fillim vuri re se beratasit ishin njerëz të urtë, të prirë për t'u rehatuar në guaskën e jetës së tyre familjare dhe shumë të kujdesshëm tua zgjeronin hapësirat e mikpritjes të gjithë ardhësve.

Qenë të sjellshëm e të rezervuar, por edhe të ëmbël në komunikim.

Ishin gjithashtu edhe temperamente artistikë, sidomos të prirë ndaj muzikës.

Vetë Luani ndihej i aftë për ta bërë një përcaktim të tillë, sepse në vitet universitare pati qenë drejtues i korit të studentëve të Fakultetit të Mjekësisë.

Ndërkohë në Berat ai u mor edhe me mbledhjen e folklorit, duke qenë madje në një festival lokal edhe në përbërje të jurisë.

Aty mjeku i ri ushtarak e kuptoi fare bukur se sa shkullmë, se sa mallim dhe sa vuajtje dashurie kishin vargjet e këngëve beratase “mora përpjetë kalanë dhe zbrita tatëpjetë” apo “psherëtima doli flakë”.

Ndërsa në qytet fati i familjes Jakova po shkonte drejt pikës më tragjike të saj, vdekjes në rrethana të errëta të Tukut (26 gusht 1959), Luan Greva dashurohej në Tiranë me Hatixhe Gjebrenë dhe fejesën zyrtare e bënë në 27 dhjetor 1959.



## **Fejesë e shumëdëshiruar, por e papritur**

Hatixhe Gjebrea e pati mbaruar shkollën e mesme me medalje ari, kurse Fakultetin e Gjuhëve të Huaja në degën e rusishtes, me Diplomë të Kuqe.

Ajo që e zgjedhur në Komitetin Qendror të Rinisë së Universitetit të Tiranës, po ashtu ishte edhe balerinë, këndonte bukur dhe i binte kitarës. Që po kaq e talentuar si sportiste, ndër të parat në Shqipëri për gjimnastikën artistike.

Ishte bionde, në fytyrë me tipare të ngrohta dhe që bënte gjeste të shpenguara afrimi, por ndërkohë që edhe tepër serioze.

E nxehta dhe e ftohta, zemra dhe arsyeja, tek ajo ishin bërë një krijim magjik.

Të gjithë kësaj të veçante i shtohesh përshtypja që linte me pamjen e saj: ngjante krejtësisht me një ruse.

Në jetën e Hatixhes shfaqja e Luan Grevës ishte pasojë e një fare coincidence. Ky, i emëruar në Berat, rikthehej në shtëpinë e vet në Tiranë me një autobus linje, i cili vinte nga Përmeti. Uniforma ushtarake e liridaljes e bënte shumë të bukur, por edhe ai vetë që një djalë dukshëm i pashëm dhe i ëmbël, si të që rritur në një familje aristokratike, ku mbrëmjeve i bihej pianos.

Mes këtyre dy bukurive të ndara nga njëri-tjetri u duk sikur një dorë me fuqi qiellore pati hyrë në mes për të kombinuar një rastësi të çuditshme: sa herë që Luani zbriste në Tiranë nga autobusi personi i parë me të cilin shkëmbehej ishte Hatixhja.

Në të vërtetë vajza që ngjante si ruse, nuk qe e panjohur për të, përkundrazi. Ishin miq nëpërmjet të vëllait të saj. Të dy shkëmbeheshin tek stacioni i autobusit që vinte nga Përmeti dhe Berati, por gjithsesi asnjë shkëndijë dashurie mes tyre nuk kishte shkrepitur. Simpatia po.

Ajo “sikur”, për t’i bashkuar, rrinte zgjuar.

Një natë patën qenë duke vallëzuar tek Parku Rinia dhe të nesërmen, kur për të qepur një fustan Hatixhja shkoi tek një dyqan rrobaqepësie, ku privatisht punonin një tufë me motra nga fisi i Shehlerëve të Dibrës, ato sapo e panë të bukurën çupë të Gjebreve, nisën të buzëqeshnin.

“Ç’keni?”, i pyeti.

“Ke qenë mbrëmë tek Parku Rinia?”

“Po”.

“Ke kërcyer”.

“Po”.

“Po ai që kërcyeve ti cili ishte?”

“Luani”.

“Ke gjë me të?”

“Jo, e kam shok të vëllait”.

Tufa e motrave pas kësaj kishin shkuar tek një kushërira e tyre e vjetër në moshë dhe e mençur në gjykim e këshillë, dhe i thanë se për Luanin paten gjetur një gocë.

Kushërira vrapoi tek nëna e këtij të fundit dhe ia tha.

“E mirë është”, iu përgjigj, por nuk nxori asnjë fjalë tjetër. Kur Luan Greva erdhi si zakonisht nga Berati e ëma ia tregoi të gjithë historinë.

“Përse nuk e merr ti?”, e pyeti një çast.

“Por unë e kam motër të shokut të ngushtë”, iu përgjigj i habitur i biri.

Pastaj papritur shtoi: “Por në qoftë se ti do...”. Kur u mor vesh lajmi se Hatixhe Gjebrea do të fejohej me Luan Grevën i vëllai i saj u trondit aq shumë sa u shtrua menjëherë në spital.

Brenga e madhe që përse shoku më i ngushtë dhe vetë motra e tij e kishin bërë marrëveshjen mbrapa krahëve. Sigurisht kjo krizë i kaloi shumë shpejt, sidomos sapo ia argumentuan se ajo miqësi nuk ishte sajuar aspak për të maskuar këtë qëllim fejese.

Që prej këtij çasti i vëllai u kthye në të kundërtën: ishte i pari në rreshtin e organizatorëve dhe të garantëve që ceremonia e fejesës të dilte sa më dinjitoze.

Fejesa, siç e thamë, u bë në 27 dhjetor 1959.

## **Pranverë sovjetike në Tiranë**

Në kryeqytet dhe në të gjithë vendin vazhdonte atmosfera e mes dhe e fundviteve pesëdhjetë, të cilën në kushtet e Shqipërisë mund ta quajmë si “pranvera sovjetike”.

Në BRSS po vazhdonte destalinizimi dhe “shkrirja e akujve”, zbutja e madhe brenda vendit e represionit politik dhe jashtë tij acarimi i Luftës së Ftohtë po këmbehej me garën paqësore ekonomike midis vendeve të kampit socialist dhe atyre të bllokut perëndimor, të quajtur kapitalist.

Në të gjitha qytetet kryesore shqiptare shfaqeshin filma rusë, por edhe italianë, botoheshin romane, kudo që të mundej nuk kishte të shtunë pa organizuar mbrëmje vallëzimi.

Rinia shkollore dhe ajo studenteske ishin në qiellin e shtatë të kësaj atmosfere gëzimi.

Lufta e klasave pothuaj nuk ndihej, në harë qenë madje edhe shumë prej të rinjve që i kishin prindërit e tyre të arratisur.

Në Tiranë taverna e Hotel Dajtit, si rregull lënë vetëm për punonjësit e ambasadave, frekuentohej masivisht nga studentët.

Një ditë të fillim vitit 1959 Hatixhesë, tek rrinte në një tavolinë me shoqet e saj, iu afrua një konsull i ambasadës ruse. Njiheshin sepse herë pas here ky vinte në Fakultet për të biseduar me pedagoget ruse.

Ishte djalë i ri dhe simpatik.

Kur iu avit Hatixhesë i tha gjithë nënkuptim: “Gjebrea, qejf kam, pare kam, moshën e kam, ku të vete?”

Por këtë pretendent hileqar dhe kokëzbrazët ajo e hoqi qafe butësisht.

Luan Greva, me të cilin këtë kohë thjesht qenë ende shokë, i pati treguar një rast të ngjashëm, të ndodhur gjatë vitit 1956, pak para se të plaste ngjarja e Konferencës së Tiranës, e cila u quajt ndërhyrje e Jugosllavisë në punët e brendshme të Shqipërisë.

Tek bashkë me dy shokë të tij po rrinin në një tavolinë të tavernës tek vendi cili në Tiranë thirrej Tajvani, ku kishte edhe një pistë vallëzimi, u erdhi pranë atasheu i ambasadës jugosllave.

Ishte me detyrë në shërbimin e fshehtë.

Ishte shqiptar nga Kosova dhe quhej Rexhep Xhija.

Qenë momente, pas vizitës së Nikita Hrushovit në Beograd, të një përpjekjeje për zbutje të marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe shtetit të Titos.

Duke qenë se Luani me shokët e vet ia prenë hovin zbuluesit diversionist, ky, paksa e zëmëruar, u kujtoi se vetë Enver Hoxha që për afrim mes dy vendeve dhe qeverive, madje ai pas pjesëmarrjes në Kongresin e Njëzetë të Partisë Komuniste të BRSS, ku me një raport sekret ishin denoncuar krimet e regjimit stalinist, i kthyer në Tiranë, pati deklaruar botërisht për “Punët e fëlliqura të Stalinit”.

Në të vërtetë Rexhep Xhija provokonte.

Kur u ngritën të iknin ky desh t'i përcillte me makinën e tij, por të tre studentët refuzuan.

Megjithatë lajmi i këtij takimi shkoi në Fakultet, veç këtu, pasi ua treguan ngjarjen fill e për pe, e mbyllën menjëherë atë histori.

## **Festivali i Rinisë në Moskë**

Në muajin korrik 1957 në Moskë do të mbahej për pesëmbëdhjetë ditë Festivali Ndërkombëtar i Rinisë. Do të merrnin pjesë në të grupe prej të gjitha vendeve socialiste. Në përzgjedhje të përfaqësisë shqiptare në Tiranë konkurruan grupe korale, veçanërisht oktete. Ndërsa Luan Greva drejtonte oktetin e Fakultetit të Mjekësisë, Hatixhja qe pjesëtare e atij të Filologjisë. Mes universitarëve ngadhënjeu ky i fundit, duke fituar të drejtën për të shkuar në Moskë në emër të rinisë shqiptare. Në grupin konkurrues për në Festival do të kishte edhe valltarë si edhe një skuadër futbollit, ajo e ekipit “Partizani”. Oktetin (tetëshen korale) të Fakultetit të Filologjisë në Tiranë e përforcuan me Anita Taken dhe Vaçe Zelën. Drejt festivalit moskovit përfaqësia shqiptare u nis me vapor nga Durrësi. Brenda një jave mbërriti në portin e Odesës dhe prej andej me tren shkoi në kryeqytetin sovjetik. Në Moskë grupi shqiptar pati sukses të plotë, sidomos vallet e Tropojës. Rusët e pëlqenin shumë atë lloj arti dhe i mbajtën shqiptarët në pëllëmbë të dorës. Kudo, sa i shihnin, thoshin me zë të lartë dhe me gëzim “Allbania”. Kudo u hapnin rrugën. Një ditë grupi i të rinjve festivalistë shkoi në një park, ku edhe do të mbahej shfaqja e asaj dite. Mes shikuesve vajzave shqiptare u ra shumë në sy për hijeshi mashkullore një djalë brun. E menduan azerbaxhanas, por ky papritmas thirri me emër Hatixhenë.

Fillimisht kjo u hutua, veç shpejt ai i kujtoi se patën qenë bashkë në klasën e katërt fillore.

Qe i nipi i ushtarakut të lartë Sadik Bekteshit. Quhej Sandër Sokoli. Ishte në Moskë për studime.

(Kur u kthye në atdhe ai bëri karrierë deri si drejtor i Uzinës Ushtarake të Poliçanit, por pas goditjes së ushtarakëve të lartë, dhe pa dalë asnjë akuzë e qartë, u arrestua dhe u pushkatua).

Gjatë pesëmbëdhjetë ditëve të Festivalit të Rinisë në Moskë, në krah të Hrushovit në tribunën e parakalimit të pjesëmarrësve ishte edhe Enver Hoxha.

Pas kthimit në Tiranë Hatixhja, e cila prej Bashkimit Sovjetik pati sjellë edhe ndonjë veshje të lehtë (mban mend sidomos një palë çorape të holla), një ditë, ndërsa ecte, ndjeu ta ndiqte dikush nga pas.

Ky pas pak i doli në krahë.

Ishte me moshë fare të re.

I tha “Jam një dashamirësi yt”.

“Urdhëro!”, reagoi me mirësjellje ajo.

“Mbrëmë ke qenë me dy shoqe të tua karshi Hotel Dajtit?”

“Po”.

“Unë kam qenë mbi ju, hipur në një pemë”, vazhdoi i porsaardhuri. “Keni folur me njëra-tjetrën”, shtoi menjëherë.

“Sigurisht”, u përgjigj plot ankth Hatixhja.

“Nuk keni thënë gjë të ndaluar”, buzëqeshi punonjësi i Sigurimit të Shtetit.

“Faleminderit!”, belbëzoi e tronditur ajo. Sidoqoftë nuk harroi t’i fiksonte fytyrën, madje arriti t’i marrë edhe emrin. Quhej Fadil.

Ky përgjues do të dukej sërish disa herë të tjera, duke qëndruar në cep të pallatit ku jetonin Gjebretë, në të gjitha rastet kur tek ta do të vinte një teze e tyre, e cila ishte e internuar në Selenicë të Vlorës.

I shoqi, luftëtar republikan në Spanjë, pas Konferencës së Tiranës, për shkak se kritikoi favoret e Bllokut, qe futur në burg.

Hatixhja e ritakoi këtë njeri të Sigurimit të Shtetit pas vitit nëntëdhjetë, rënies së diktaturës, ndërkohë që bëhej ceremonia e rivarrimit të eshtrave të një të burgosuri politik. U gjend përballë tij jo vetëm në funeral, por edhe gjatë drekës përkujtimore në Shtëpinë e Oficerëve.

“Ku të kam parë?”, i tha ky.

“Ndoshta kur kam qenë studente”, iu përgjigj Hatixhja.

“Po ku?”, nguli këmbë tjetri, i cili vërtet nuk po e pikaste dot.

“Ti mos je Fadili?”, mëshoi fjalët pyetëse ajo.

“Jo”, shkundi kokën fort, si me turfullim, ish-sigurimsi, “nuk e kam emrin Fadil”.

Në drekë, mes fjalimbajtësve, u tha se ai qe një lloj zëvendësi i kryetarit të Shoqatës së të Persekutuarve nga regjimi komunist.

Kur pjesëmarrësit u shpërndanë iu afrua enkas Hatixhesë dhe i belbëzoi nën zë: “Faleminderit shumë për heshtjen!”



## Vallzim në Hotel Kolombo

Para se të vinte në Berat tashmë pranë bashkëshortit të saj, Hatixhe Gjebrea kishte parë në atdheun e saj vetëm vendlindjen, Tiranën, Kavajën si edhe Krujën, ku, pas përfundimit të studimeve universitare, e emëruan për një vit si mësuese të gjuhës ruse.

Luan Greva kishte dy mote që punonte në qytetin e “Një mbi Një Dritareve”, kur ajo u transferua për punë këtu. Ndërsa pa për herë të parë nga larg kështjellën, pastaj lumin Osum që rrëshqiste poshtë një ure, e cila thirrej e Vajgurores, kur në të majtë vështroi qytetin naftëtar me emrin e Stalinit si edhe buzë tij një aerodrom luftarak, Hatixhja u emocionua.

Kur hyri në Berat iu duk se gjithçka vezullonte.

Tërë pejsazhin, banesat si edhe sipërfaqen e lumit, dielli e vishte si me një ylber.

Ndoshta gjithçka e tillë, tepër mahnitëse, Hatixhes iu bë vetëm prej një sajese të fantazisë së saj, apo nga që po i gëzohej strehës së parë të familjes së saj të re, por gjithsesi ditët e muajt pasues nuk ja çbukuruan dot qytetin.

Në Berat Luani jetonte në një dhomë të një shtëpie private, i zoti i të cilës qe një vendas me emër të gëzueshëm dhe popullor: Taq Gjogu.

Në të ishte një krevat i ngushtë (tek) si edhe një dollap i vogël muri, që të dyja nga ato të fjetinave të ushtarëve.

Bashkë me një sobë metalike, disa batanije dhe dy palë çarçafë, ato qenë në inventar të regjimentit të artilerisë. Shtrati ishte aq i pamjaftueshëm për dy njerëz sa, kur secili prej tyre dëshironte të kthehej në krahun tjetër për

t'u rehatuar më mirë që ta zinte gjumi, lajmëronin më parë shoshoqin me një "Mbahu!"

Sepse një lëvizje e gabuar dhe krevati përmbysëj.

Gjithsesi në atë dhomë të mobiluar ushtarakisht ftonin miq të shumtë dhe në dimër i qerasnin me gështenja që i piqnin mbi sobë.

Hatixhja e bukur teshat e saj ja delte t'i mbante në dollapin e ngushtë metalik pa iu krijuar qoftë edhe një rrudhë dhe bashkë me Luanin, elegantë që të dy, shkonin të kërcenin në restorantin e Hotel Kolombos, i cili ndodhej në shëtitoren kryesore të qytetit.

Madje ata u bënë shkaktarë që ky, vallzimi publik i çifteve në atë mjedis, të bëhej rregull edhe për vetë beratasit.

Sepse më parë në sallë edhe pse binte një orkestër, askush nuk ngrihej të kërcente, prandaj edhe një ditë Luani e thirri kamarjerin dhe i tha: "Na hap pak vend të vallëzojmë!"

Ky u përgjigj: "Nuk e di, të pyes".

Pas pak u kthye dhe shtyu tavolinat mënjanë.

Hatixhja dhe Luani kaq deshën dhe menjëherë brofën, i hodhën duart njeri tjetrit mbi sup dhe në bel.

## **Pasardhëse e Dëshmorit të Kombit**

Për festivalisten e Moskës Berati nuk ishte i dashur vetëm sepse atje kishte të dashurin dhe tashmë burrin e vet, por lidhja shpirtërore që akoma shumë më e thellë. Ai ishte qyteti i gjyshit, Abdyl Bakiut, dhe i të vëllezërve të tij, pra i xhaxhallarëve të saj, me pak fjalë i tërë familjes Gjebrea.

Në fillim të shekullit këta patën lënë vendlindjen, Gjirokastrën dhe qenë vendosur këtu.

Në Berat gjyshi kishte eshtrat, bashkë me tre të tjerë, jo në një varrezë të zakonshme, por poshtë një lapidari të shumë adhuruar prej vendasve: atë të Katër Dëshmorëve të Kombit.

Siç më pas do ta përshkruante historinë e asaj jete i vëllai i Hatixhes, Shpëtimi, i cili është një mjek me pasion të dukshëm edhe për historinë, referuar gazetës “Demokracia” të ditës së shtunë, 6 prill 1935, Abdyl Baki Gjebrea “Në vitin 1912 së bashku me shokë të tjerë ngre flamurin Kombëtar në qytetin e Beratit dhe prej andej Ismail Qemali e përfshiu në Qeverinë e tij, duke e caktuar Drejtor të Financave dhe më vonë si nënprefekt në Skrapar, ku qëndroi nga viti 1913 deri në vitin 1914, datë në të cilën rebelët e Musa Qazimit zaptojnë Beratin, duke djegur shtëpinë e Baki Gjebresë dhe më vonë duke e dënuar me vdekje”.

Ky, shkruan Shpëtimi, bëri çmos për ta shtënë në dorë, “deri sa arriti ta arrestojë atë në Poliçan të Skraparit.

Së bashku me të u arrestuan edhe patriotët e tjerë, Dëshmorët e Kombit Ismail Klosi, Hajredin Fratari dhe Muharem Lleshi.

Prefekti Eqerem Kozara mori përsipër gjykimin e këtyre patriotëve, të cilët brenda pak ditëve i gjykoi dhe i dënoi me vdekje.

Ja çfarë thuhej në vendim: “I famshmi ngatrestar Abdyl Bakiu (Baki Gjebrea) nga Gjirokastra, ish sekretar batalioni dhe më vonë sekretar regjimenti i ushtrisë Otomane, i rritur dhe i ushqyer me bukën dhe dhuratat e shtetit dhe popullit otoman, ka tradhtuar ushtrinë në kohën e Luftës Ballkanike, duke ushqyer dhe shërbyer mendimit të Ismail Qemal bej Vlorës, duke u përpjekur pa reshtur për sigurimin e independencës së Qeverisë së Vidit... Vendi, koha e ekzekutimit 25 prill 1915”.

Para se ta vrisnin me mitroloz Bakiu deklaroi “Protestoj para juve dhe para historisë për akuzën që më bëni, duke më cilësuar si tradhtar të Atdheut. Përkundrazi ne jemi patriotë, jemi përpjekur dhe kemi punuar vetëm për lirinë e Shqipërisë. Tradhtar dhe të poshtër jeni ju, që të verbuar nga padituria, po bëheni vegla të të huajve për shkatërrimin e Shqipërisë. Por duhet ta dini se në këtë vend s’ka për të shkelur më këmba e osmanliut, siç kujtoni ju o të çmendur, por sigurisht do të valoj këtej e tutje dhe përgjithnjë vetëm Flamuri i kuq i Shqipërisë. Rroftë Shqipëria!”

## **Kushëri i parë me Nexhmije Hoxhën**

Baki Gjebrea la pas tre djem: Kastriotin, Qazimin (të atin e Hatixhes) dhe Myrtezanë që emigroi në Amerikë dhe vdiq atje beqar.

Kur ndodhi pushkatimi me mitralim, Qazimi ishte 14 vjeç. Pasi kishte përfunduar shkollën qytetëse të Beratit dhe marrë një bursë nga qeveria austriake, ai pati shkuar për studime në qytetin Grac të Austrisë, në një gjimnaz.

Ishte bashkë me Eqrem Çabejin dhe Spiro Moisiun. Banonin në një jetimore dhe duke qenë se pas vrasjes së të atit nëna, Hatifeti, ndodhej në shtëpinë e xhaxhait, pra të vëllait të madh të babait, Rustemit, Qazimi përfundoi në Grac vetëm tre klasë dhe u kthye në Berat për t'u kujdesur për të ëmën.

Ramize Gjebrea (emri kësaj partizaneje të shquar tashmë njihet prej çdo shqiptari për vrasjen e saj mizore vetëm sepse, e fejuar me Nako Spiro i shpifën se kishte rënë në dashuri me shokun e armëve Zaho Kokën), që bija e Rustemit.

Këtë vajzë xhaxhai Qazimi e kishte si motër.

Kur Hatixheja vazhdoi në Tiranë shkollën pedagogjike pyetja e parë e mësueseve të saj që “çfarë e ke pasur Ramizenë?”

Pas kësaj në çdo bisedë flitej vetëm për bukurinë dhe zgjuarsinë e saj.

Nako Spiro pas lufte, deri sa vdiq me vetëvrasje të detyruar, i martuar tashmë me Liri Belishovën, çdo të diel e ftonte për drekë nënën e Ramizesë, Tafijen. Belishova para se të ndërronte jetë, çdo 6 mars, përvjetor i trishtuar i kësaj

vrasjeje mizore, e telefononte Hatixhenë. Njëherë i qe shprehur se tek ajo kishte parë shumë karakteristika të Ramizesë.

Duke qenë se Luan Greva është kushëri i parë me bashkëshorten e Enver Hoxhës, Nexhmijen (i ati i të cilit qe vrarë gjatë luftës nga serbë ndërsa bashkë me të tjerë mbronte qytetin e Dibrës) edhe kjo, kur ky shpalli lidhjen e dashurisë me vajzën nga familja Gjebrea, pati pyetur se çfarë e kishte e fejuara e tij Ramizenë.

Qazimi, pasi në vitin 1934 qe rikthyer në Gjirokastrë, gjatë luftës, ndërsa mes komunistëve dhe ballistëve ende nuk kishte shpërthyer armiqësia, ishte me këta të fundit. Kur mes tyre nisi ndeshja e armatosur ai u largua nga të dy palët, duke mbetur i mënjanë.

Kur Gjirokastra u pushtua prej gjermanëve dhe njohësit e gjuhës së tyre i thirrën për të shërbyer si përkthyes, u hap fjala se kjo ndodhi edhe me Qazim Gjebrenë. Por ky shërbim i tij nuk u krye kurrë, ishte thjesht një fjalënjajë. Veç në shtabin partizan vrapoi opinionin tjetër: që ai kishte bashkëpunuar me pushtuesit.

U vu menjëherë në listën për t'u pushkatuar dhe ky kob fare lehtë do të ndodhte sikur të mos qe një drejtues i lartë i nacionalçlirimtarëve lokalë, i cili ndërhyri fort dhe sqaroi gjithçka.

Pas lufte, rigoroz siç ishte, saktësisht "gjerman" në kulturë e në të sjellur, kur hartoi biografinë e tij, Qazim Gjebrea shkroi se pati qenë me Ballin Kombëtar.

Kjo i kushtoi shumë.

Nga sekretar komune ca kohë, pastaj drejtor i fabrikës së këpucëve, e ulën në magazinier dhe më pas, gjithë kohën e moshës për punë, e kaloi ashtu.

Ishte në një punë të tillë tek Uzina Mekanike në Tiranë, kur një ditë aty erdhi për vizitë Enver Hoxha. Qazimi u përpoq të fshihej mes të grumbulluarve për pritjen festive, por atij

ia kapi syri. Drejtor qe Hajredin Çeliku dhe Hoxha e pyeti këtë nëse qe e vërtetë që aty punonte edhe Qazim Gjebrea. Sa ia pohuan e thirri menjëherë dhe e pyeti nëse kishte ndonjë hall.

“Jo, nuk kam, faleminderit! Fëmijët i kam në shkollë”, qe përgjigjur.

Që prej këtij çasti, edhe pse tashmë në prag të pensionit, ndryshoi dukshëm qëndrimi politik dyshues ndaj tij. Kur Enver Hoxhës i ndërroi jetë nëna, Gjyloja, Qazimi me dy bashkëmoshatarë pleq nga Gjirokastra shkoi për ta ngushëlluar. Për shkak se deri ato çaste kishte pritur njerës dhe Hoxha për pak kohë shkuar të shlodhej, kur ata tre ngushëlluan ai nuk qe aty.

Pas kësaj ata shkuan në kafën sipër Pallatit të Kulturës dhe ende nuk e dinin që ndërkohë punonjës të Sigurimit të Shtetit kishin trokitur me ngut në të tre shtëpitë dhe patën pyetur se ku ndodheshin. Enver Hoxha i kishte ftuar ta vizitonin sërish dhe kur të tre të nesërmen rihynë në shtëpinë e tij, ai u kërkoi falje që një ditë më parë nuk kishte ndodhur të ishte aty për t'i pritur personalisht.

Ky gjest ia kishte ngrohur zemrën Qazim Gjebresë, por nuk i fashiti kurrë një brengë tjetër.

Kjo i kishte filluar në vitin 1958, kur Enver Hoxha vlerësoi për herë të parë pozitivisht lëvizjen haxhiqamiliste, çfarë donte të thoshte se zvogëlonte shumë rolin e martirëve që kishin dhënë jetën kundër këtij rebelimi filootoman. Gjithsesi sa herë që mundte gjente rastin të shkonte në Berat dhe tek lapidari i Katër Dëshmorëve të Kombit të vinte një tufë me lule.

Tashmë ai vend i shenjtë, krijim i përkryer artistik i skulptorit Dhimitër Çani, nuk kishte vëmendjen e mëparshme, atë të viteve tridhjetë, kur u ndërtua, sepse pranë, në të djathtë, qe lartuar një bust i madh i Stalinit dhe në të majtë një lapidar fare mediokër, tepër voluminoz,

kushtuar vendkrijimit të batalionit partizan të rinisë me emrin “Margarita Tutulani”.

Qazimi do të ndërronte jetë në vitin 1970 dhe nuk do të vuante një brengë të re. Në Gjirokastrë, ndërsa me emrin e të atit, dëshmorit të kombit Baki Gjebrea, ishte një rrugë, gjatë periudhës kur në Presidencë qe Sali Berisha, ai emër u hoq.



## **Puthje në Paris**

Këto çaste kur po shkruajmë për Hatixhe dhe Luan Grevën ajo tani është 83 vjeç dhe ai 88.

Shumë vështirë tua besosh këtë moshë jo thjesht vetëm nga pamja e freskët, por nga dashuria rinore që vazhdojnë t'i shprehin njëri-tjetrit.

Për t'ia bërë të qartë lexuesit këtë karakteristikë të tyre do të na duhet të rrëfejme tërë familjen.

Kanë dy djem që jetojnë në Francë. Ariani, i cili është më i madhi, ka lidhur kurorë me francezen Fransoise dhe kanë vajzën Sharlene si edhe djalin Arnaud.

Në katër faqe speciale që “Rilindja Demokratike” botoi në 2011 për gjithë familjen Greva e më dukshëm për Arianin, thuhet se përveç se arbitër shumë i njohur ndërkombëtar i basketbollit ai ishte edhe “drejtor komercial i kompanisë së madhe të tekstilit “Filix”, që ka marrëdhënie pune me 90 shtete në botë”.

Një muaj më parë kjo gjendje e tij e pesë viteve të shkuara ka ndryshuar: tani është bërë pronari i saj.

Ndërkohë Arnaud (arnauti), kur e gjyshja Hatixhe e pyeti nëse kishte ndonjë të fejuar, ky i tha se zezake dhe arabe nuk e donte.

“Do vetëm franceze?”, e pyeti.

“Jo patjetër franceze, por edhe shqiptare”, i erdhi përgjigja e gëzueshme.

Biri i dytë i çiftit Greva është mjek dhe quhet Aksel, e shoqja Patrizia. Fëmijët e tyre thirren Leane dhe Donan. Të dy çunat prej prindërve kanë marrë zakonin e mirë të duhen shumë me bashkëshortet.

Franceskat i vlerësojnë shumë për këtë cilësi. Kur Ariani u martua me Fransoise, kjo i tha Hatixhes: “Kam qejf të shkojmë bashkë siç kanë shkuar prindërit e tyre. Si ke vepruar?”

Atëherë ajo i shpjegoi “sekretin” e parë: çdo mëngjes i bëja gati veshjet.

“Këtë nuk e bëj”, tha franceska.

“Sekreti” i dytë, vazhdoi Hatixhja: nuk haja kurrë bukë pa e pritur të hanim bashkë”.

“Edhe këtë nuk kam ndërmend ta bëj”, reagoi e reja, por pranoi ta dëgjonte se edhe kur dy djemtë u rritën dhe u bënë studentë dhe Luani vinte vonë nga spitali, Hatixhja gjysmën e pjatës e hante me të bijtë dhe gjysmën tjetër kur vinte i shoqi.

“Po sekreti i tretë?”, ngulmoi Fransoise.

“I gatuj gjëra të reja, në treçerkun e rasteve surpriza”.

“As këtu nuk më ke. Ka edhe sekret të katërt?”

“Ka. Kur del nga shtëpia shkoj në dritare dhe e shoqëroj me sy, kur vjen sërish e pres në dritare”.

“Uf!”, ja bëri franceska dhe u shkri së qeshuri: “Qenka punë shumë e rëndë!”

Rrëfimin e pesë “sekreteve” të saj të dashurisë me të shoqin Hatixhja nuk e çoi më tej, sepse kishte edhe një: ta puthte Luanin.

Edhe kur fundjavave shkojnë në plazhin e Durrësit, ku kanë një apartament të vogël, dhe shëtisin buzë detit, ajo e puth.

E ka puthur posaçërisht në mes të Parisit, kur shkuan atje për herë të parë (“Luan, këtu do të puthemi sepse as na sheh, as na njeh dhe as në pyet njeri”).

## **Netët e Bardha në Shën Petersburg**

Kur Luan Greva mbushi tetëdhjetë vite të dy bijtë u bënë surprizë prindërve të tyre me një udhëtim në Venecia.

Kur Hatixhja festoi shtatëdhjetëvjetorin, surpriza e re që shumë speciale: një javë qëndrim në Shën Petersburg dhe në Moskë, duke nisur nga 25 qershori.

Kjo donte të thoshte se do të përjetonin të gjithë periudhën e Netëve të Bardha, pra kur të njëzetë e katër orët janë krejtësisht ditë.

Ishte njëzetë vjeçe kur për herë të parë shkoi në kryeqytetin rus, në Festivalin e Rinisë. Po rikthehej pas plot pesëdhjetë vitesh. Qendra historike e Moskës ishte po ajo, por në Mauzole mungonte trupi i balsamosur i Stalinit, i cili ishte atje kur në 1957 e vizituan.

U bëri përshtypje se tek sheshi para Bolshoj Teatrit nuk që vënë asnjë bust i ri, për shembull i ndonjë balerini apo edhe i ndonjë shkrimtari. Vazhdonte Karl Marksi, Frederik Engelsi dhe diku thirrja “Proletarë të të gjithë vendeve, bashkohuni”.

Në Shën Petërsburgun e mahnitshëm, Leningradin e dikurshëm, emri i vjetër që rikthyer vetëm për qytetin e vjetër. Gjithçka tjetër quhej sërish Leningrad.

Kryqëzori “Aurora”, që kishte shënjuar nisjen e revolucionit bolshevik ishte aty, i mirëmbajtur fringo.

## **Vjosa Jakova**

Hatixhja dhe Luani ikën nga Berati në 1969.

Këtë kohë Mita Jakovën dhe katër fëmijët e saj i larguan nga qyteti i lashtë për t'i vendosur në periferi të Fierit.

Në parkun e lagjes Murat Çelebi të Beratit vazhdonte të vallëzohej, po ashtu edhe brenda Hotel Kolombos.

Kjo do të zgjaste deri në vitin 1973, kur gjithçka e tillë do të ndalohej.

Dy nuset franceze e duan shumë qytetin e “Një mbi një dritareve” dhe kur erdhën për herë të parë në Shqipëri, shkuan atje. Mbetën të pagoja nga sa panë. Ndërkohë nga familja e prindërve Leman dhe Qazim, tre djemtë Pëllumb, Shpëtim dhe Fitim, si edhe Hatixhja, shkojnë e vënë një tufë me lule tek lapidari i Katër Dëshmorëve të Kombit.

Por bashkë me mrekullinë e arkitekturës dhe të shpirtit paqësor të beratasve mësuësja e gjuhës ruse në këtë qytet për pothuaj një dekadë, nuk mund të harronte dot fatin e dhimbshëm të familjes Jakova.

Nuk i hiqen nga mend përgjigja e vajzës së madhe të Mitës dhe Tukut, kur e pyeti si saktësisht e kishte emrin: Vjosa apo Vjollca?

“Vjosa moj zysh, sepse babi ia ka shfaq dashurinë mamit, kur në luftë kanë kaluar lumin Vjosa”.

## **Mita, Tuku, diktatori**

Sulmi politik i Enver Hoxhës kundër Tuk Jakovës është një mitralim i vërtetë në dy batave të gjata dhe të pamëshirshme: 1951 dhe 1955.

Duke qenë se depërtimi tek arsyet e vërteta përse Hoxha kreu internimin, burgosjen dhe më pas si ndodhi që gijotina e gjithëpushtetit të tij funksionoi në mënyrë automatike, për t'ia marrë jetën Tukur, do të jetë temë e gjithçkaje që më tej do të shkruajmë në këtë libër.

Tek tërësia e akuzave të Enverit për Tukun do të qëndrojmë fare pak.

Janë shumë pak të besueshme-

Veç ajo që është shumë e habitshme ka të bëjë me një rrethanë, të cilën po e tregojmë menjëherë: Tuk Jakovën e ka sulmuar edhe Nexhmije Hoxha.

Ndërsa i shoqi, të paktën, për shkak se në prill 1985 ndërroi jetë, që prej këtij viti nuk e ka goditur dot më, këtë vazhdoi dhe e bëri me zell bashkëshortja e tij.

Ja fragmenti që ndodhet në faqen 319 të librit të saj “Jeta ime me Enverin” (1998), kur flet për Konferencën e Tiranës (maj 1956): “Ata nuk guxuan të dilnin në mbrojtje të Koçi Xoxes, por kërkuan rehabilitimin e Tuk Jakovës dhe Bedri Spahiut, që ishin dënuar me burgim si elementë antiparti në mbështetje të vijës jugosllave, duke ngritur çështje të tilla se gjoja nuk është Enver Hoxha që ka themeluar PKSH, por kanë qenë Miladini e Dushani dhe pse këta nuk vihen në stendat e Muzeut etj.

Për të sqaruar ata që nuk e njohin historinë e Partisë së Punës, po shënoj, në parantezë, se Bedri Spahiu nuk ka

qenë i prirur për marrëdhënie të mira me Jugosllavinë. Nga kjo pikëpamje ai ishte një “nacionalist”, por në Plenumin e Komitetit Qendror që dënoi Tuk Jakovën për pikëpamjet e tij antiparti në mbështetje të Jugosllavisë titiste (duhet thënë se Dushan Mugosha e kishte bërë punën e tij helmuese me të kur ishin bashkë në Brigadën e Parë Sulmuese, në kohën e Luftës), Bedri Spahiu u solidarizua me Tukun nga mëria që kishte ndaj Enverit, nga që ky e kishte kritikuar për gabimet që kishte bërë Bedriu në Gjirokastër, qysh gjatë pushtimit italian”.

Tani fare disa radhë të tjera, por nga Enver Hoxha, shkruar e deklaruar publikisht në 23 shkurt 1953: “Mbi veprimtarinë oportuniste të shokut Tuk Jakova.

Nga analiza që i bëri Plenumi i IX i Komitetit Qendror të PPSH të gjithë veprimtarisë së shokut Tuk Jakova, anëtar i Byrosë Politike dhe Sekretar i Komitetit Qendror, u konstatua se veprimtaria e shokut Tuk Jakova si udhëheqës dhe si komunist, që nga viti 1943 dhe deri më sot, karakterizohet nga një oportunizëm i thellë, liberalizëm i patolerueshëm, mungesë urrejtje në masën e duhur kundrejt armikut të klasës, mungesë të vigjilencës revolucionare, mungesë përpjekjesh për ngritjen ideologjike personale dhe neglizhenca serioze në kryerjen e detyrave që i ka pas ngarkuar partia...”

Trembëdhjetë paragrafe më poshtë: “...Në rast se partia do të ishte vënë në rrugën oportuniste të shokut Tuk Jakova, kjo pa tjetër do të çonte në likuidimin e partisë dhe të pushtetit tonë popullor..”.

Në 1955: “Nga analiza që i bëri plenumi i Komitetit Qendror të partisë më 15-17 qershor të këtij viti veprimtarisë së Tuk Jakovës, anëtar i Komitetit Qendror të partisë dhe zëvendëskryetar i Këshillit të Ministrave ...Duke gjykuar dhe interpretuar nga pozita anti-parti, anti-marksiste, revizioniste dhe karrieriste zhvillimin e situatës

ndërkombëtare, Tuk Jakova ka pasur formuar bindjen se duhej të përmysej vija e drejtë marksiste-leniniste e partisë sonë dhe të zëvendësohej me një vijë të përgjithshme trockiste, nacionaliste borgjeze dhe kapitullonjëse e një vijë e tillë duhej të ndërtohej nga një udhëheqje anti-marksiste me Tuk Jakovën në krye...

Tuk Jakova është për revizionimin e vijës së partisë në drejtimin e shuarjes së luftës kundra tendencave anti-parti, ay është për një jetesë paqësore me tendencat antiparti në gjirin e partisë, është për shndërrimin e partisë sonë marksiste-leniniste në një parti borgjeze dhe social-demokrate...”

## **24 maji, ditëdashuria e shndërruar në ditë fatkeqësie**

Në fillim të marsit 1943, në Korçë, ku jetonte familja Leka, bija të së cilës qenë, bashkë me dy vëllezër, Dhora e Mita (kjo e fundit kishte sapombushur të shtatëmbëdhjetat dhe qe nxënëse në klasën e gjashtë të Liceut), u shpall shtetrrëthim. Në banesën e tyre, e cila qe bazë shumë aktive e luftës kundër pushtuesve, mbërriti me një frymë kryetari i këshillit nacionalçlirimtar dhe u tha: “Do t’ju rrethohet shtëpia, prandaj ikni!” Kështu nëna me të katër fëmijët e saj (i ati prej vitesh nuk jetonte më), ikën menjëherë dhe u strehuan në një banesë tjetër, tek familja Stratoberdha, edhe ajo me Lëvizjen Nacionalçlirimtare.

Dëgjuan tërë natën krismat e armëve që afroheshin dhe kur ato mbërritën fare pranë, u futën të gjithë në mbi tavan, mes pezhishkave që u ranë mbi fytyrë e trup.

Por italianët nuk u ndalën, shkuan më tej në operacionin e tyre të spastrimit.

Shtetrrëthimi u prish vetëm pas dy ditësh dhe për të dalë nga Korça familjes Leka iu desh të visheshin si fshatarë. Shkuan në Voskopojë, qytezë nën kontrollin e partizanëve, ku në Shën Prodhon, tek Manastiri, ndodhej edhe një spital luftime.

Mita (Dhimitra Leka) ndodhej këtu kur në 25 mars i braktisi mësimet dhe erdhi në Voskopojë në një konferencë rinie të qarkut e gjithë klasa e saj. Më pas të gjithë liceistët e ardhur qëndruan me partizanët.

Ishte në muajt e fillimit të jetës së re në Voskopojë kur pa për herë të parë Sejfulla Malëshovën, të porsardhur nga



Franca: Po ashtu edhe Miladin Popoviçin, i cili i dukej njeri i mirë si edhe Dushan Mugoshën, që prej natyre i linte përshtypjen e një të rrepti.

Pa edhe Enver Hoxhën, i cili atë kohë nuk qe i njohur.

Madje ishte rasti i takimit me të, kur Dhimitra kuptoi se kishte emër si shënjuese e mirë. Ndërsa në një farë poligoni po provonin të gjithë të qëllonin, Hoxha iu afrua dhe i tha “Moj shoqja Mita më kanë thënë që ti shtie mirë! A nuk do ta provosh edhe tani?”

“Shtini ju sefte!”, i qe përgjigjur ajo, ca për modesti dhe ca për respekt.

Kur në 25 gusht 1943 u krijua Brigada e Parë Sulmuese Dhimitra u bë pjesë e saj, duke u rreshtuar në batalionin e katërt, saktësisht në kompaninë e tretë dhe në skuadrën e tretë.

Në majin e vitit 1944, kur në përbërje të forcave për sigurinë e tij, po shkonin në Kongresin e Përmetit, rrugës ku ndodhej një shtab luftarak, Miladin Popoviçi i pati dhuruar një pushkë të shkëlqyer.

(“Mita ti shtie shumë mirë, prandaj unë kam qejf të të dhuroj një maliher”).

Të gjitha këto hollësi si edhe shumë të tjera duhet t'i marrësh vesh në një bisedë kokë më kokë me Mitën, sepse ka prirjen të jetë e rezervuar dhe se nuk i ka shkruar një libër kujtimesh.

I vetmi që ajo ka botuar titullohet “Letërkëmbim i dhimbshëm”, publikuar në 1999, i cili përfshin korrespondencën me të shoqin e saj në vitet e internimit dhe të burgosjes së tij, deri në çastin e vdekjes.

Periudha e vetërrëfimit: 1957-1959.

Të dëbuar në Berat, pasi në nëntor 1956 u pati ardhur njoftimi se aty qenë internuar për pesë vjet, në 24 maj 1957 ndëshkimi politik u bë më i ashpër. U krye izolimi i plotë i Tukut në Kalanë e Kaninës.

Vështirë të mendohet se caktimi i kësaj date ka qenë thjesht një rastësi.

Enverizmi ishte një regjim i organizuar mjaft mirë në bizantinizmin e vet.

Dihej prej Hoxhës e të tjerëve krerë që 24 maji ishte një ditë shumë e shenjtë për çiftin Jakova. Qe ditëdashuria, ditëfejesa dhe madje ditëdasma e tyre.

Në këtë 24 maj ndërsa nëpërmjet Kongresit të Përmetit pushteti komunist i pasluftës do të hidhte themelet e tij të plumbta, do t'i ngrinte të vetat brishtësisht edhe familja Jakova.

Por i pari shumë shpejt do të vërsulej të shkatërronte të dytin.

Sipas librit të letërkëmbimit, dy ditë më pas nga kjo ngjarje tronditëse (katër fëmijët e vegjël mbetën pa baba), Tuku, duke dëshmuar qëndresë të fortë psikologjike, po ashtu dëshmuar natyrën e tij krejt paqësore si edhe modestinë e një punëtori marangoz që jetën e pati nxjerrë me djersën e vet, i bëri bashkëshortes letrën e parë.

Një fragment i saj: “Të dashurit e mij! Mita, Vjosa, Gimi, Besnik, Bujana. Harrita mirë në vendin që më kanë caktue. Këtu klima asht e mirë, ushqimin na i japin të mirë e të bollshëm. Kohën e kalojmë mirë, lozim shah, lexojmë libra, tregojmë përralla dhe historira, kështu që nuk po mërzitemi fort. Këtu nuk ka mundësi të paktën tash për tash të punoj zanatin dhe të nxjerr ndonjë lek”.

Më 7 qershor 1957 do t'i shkruante të shoqes: “Fëmijve thuaj të bëhen të mirë, të mos sillen rrugave dhe të dëgjojnë ty, se kur të kthehem nga shërbimi do t'i due shumë dhe veçanërisht ata që janë bërë ma të mirë e ma të ndigjueshëm”.

(“Dërgimi me shërbim” ishte një sajese për të mos u shkaktuar të vegjëlve ndonjë traumë, por që nuk mbijetoi gjatë).

Në 15 shtator 1957 Tuku i kërkoi Mitës gazetatat në rusisht “Pravda” dhe “Kohët e reja”.

E theksojmë këtë hollësi, sepse Enver Hoxha e pati akuzuar se ishte indiferent dhe mosmirënjohës ndaj Bashkimit Sovjetik dhe Nexhmija se antisovjetizmi i Tukut vinte prej lidhjes së ngushtë të tij me jugosllavët. Vëmë në dukje po ashtu një detaj: Ditëdërgimi i kësaj letre që ditëlindja e djalit të tyre, atij që si fizik dhe temperament i ngjante më shumë të atit, Gimit.

Mbushte 10 vjeç.

Në 25 tetor letra tjetër e Tuk Jakovës thoshte që në fillim “Dje “festova” 5 mujorin e arrestimit. Bleva pak raki dhe e piva duke ju kujtue ju dhe ditën fatkeqe të 24 majit”. Ditëdashuria e tyre u që shndërruar në ditë fatkeqësie!

## **“Xhan i Mitas!”**

Në 8 nëntor 1957 prej një letre tjetër të tij mësojmë se është dita e lindjes së vetë Tuk Jakovës.

Ja edhe një simbol tjetër i trishtë i një kohe me shumë pabesi. Në 8 nëntor komunistët shqiptarë patën themeluar partinë e tyre, e cila shumë shpejt do të bëhej partia e Enver Hoxhës dhe e gjithëpushtetit të tij.

Çfarë duhet të ketë ndjerë Tuk Jakova në ato dy tetë nëntor lindjeje (1957-1958), të cilat i kaloi në një izolim më represiv në Zvërnec dhe pastaj në Burgun e Vjetër në Tiranë, i dënuar nga partia e tij?

Duke qenë se letrat e Mitës të vitit 1957 hetuesia nuk ia kthehu, në librin e saj epistolar e para e tyre që shfaqet është e 12 janarit 1958, nisur nga Berati.

Në 27 prill Tuku i shkruante: “Shumë e dashur Mita, kjo është letra e parë që po të shkruaj nga burgu siç të kanë thënë edhe ata shokët e degës aty, unë u dënova me 20 vjet burg”.

Në 6 maj ajo e thërret shokun e saj të jetës me fjalët e ëmbla “Xhan i Mitas”.

Në 24 maj 1958 letra e nisur nga Burgu i Vjetër nis “Kjo ditë për ne ka qenë gjithnjë shumë e dashtun. Çdo vit kjo datë na përtërinte kujtimet e paharrueshme që na lidhin ne të dyve”.

## **Ta jap fjalën Tuk**

Në kongresin e Përmetit nga komisar i Brigadës së Parë Tuk Jakova u emërua komisar i Divizionit të Parë.

Mori edhe gradën e kolonelit.

Në ato ditë, pas vrasjes së Ramizesë dhe deklarimit të Nako Spiros se ky qe një krim, sikur edhe prej mosmiratimit që kësaj sjellje i pati bërë edhe vetë Enver Hoxha, mes delegatëve dhe partizanëve të shumtë në Përmet u krijua një atmosferë më e çlirët për dashurinë.

Dhora Leka ato ditë ishte në gjendje shumë të rëndë shpirtërore, sepse i qe vrarë, prapa krahëve dhe në mënyrën më të dyshimtë, i fejuari, Jorgo Plaku, komisar i çetës së Devollit.

Nga që, sepse kishte mbaruar Tekniken e Tiranës, dinte anglisht, ai rrinte vazhdimisht me një mision britanik. Flitej se ia kishin marrë jetën pikërisht për shkak të këtij bashkëpunimi.

Një ditë ndërsa Dhora dhe Mita po ecnin nëpër qytet, përballë tyre u shfaqën Tuk Jakova dhe Miladin Popoviçi. Tuku i thirri të motrën dhe i tha: “Do të vish pak tek baza ime”.

Pastaj shtoi: “Do të bisedojmë. Le të vijë edhe Mita!”

Kur shkuan, Dhora hyri brenda në zyrën e komisarit, kurse Dhimitra qëndroi në korridor.

Kur e motra doli, i tha: “Të kërkon Tuku!”

Atëherë Mita hyri.

Të dy u ulën në një si gjysmë divani.

Tuk Jakova nisi të fliste: “E di pse të thirra edhe ty? Sepse Dhora është shumë e dëshpëruar për vrasjen e të fejuarit.

Nuk është mirë kështu, ka rënë moralisht. Duhet t'i flasësh, t'i japësh kurajë të mos e lëshojë veten”.

“E di, iu përgjigj Mita, nga ajo vdekje edhe unë u dëshpërova shumë sepse ishte shumë njeri i mirë”.

Më pas komisari e pyeti: “Po ti si po shkon në brigadë?”

“Shumë mirë, shoku Tuk, por nuk jam e kënaqur për shumë thashetheme që kam dëgjuar”.

“Çfarë?”

“Nuk guxoj të qesh një çikë me një djalë dhe më hapin fjalë”.

“Pse, çfarë të kanë thënë?”

“Më kanë thënë për këtë dhe atë, edhe për ju shoku Tuk më kanë thënë. Po pse ne të dy kemi gjë? Ja kemi gjë ne të dy?”

Ai se si e pa. Mita u hutua krejt. Ja kishte thënë komisarit këtë brengë të saj fare sinqerisht, sepse i kishte vërtet një shqetësim të madh pyetjet “Ke gjë me këtë apo atë”. Mes shumëve i kishin përmendur edhe emrin e Tukut.

Asgjë nuk kishte me kërkënd, por fjalënaja ndizej prej natyrës së saj të shoqërueshme dhe të gëzueshme. Mita këndonte nëpër pushimet e brigadës apo kur shpërndaheshin nëpër baza. I binte edhe kitarës, madje edhe kur ajo ishte qull nga shirat. Kjo fundit i vinte pas bashkë me intendencën, rrinte tek mushka që mbante ushqimet.

“Po sikur kjo të ndodhte Mita, çfarë do thoshe?”

Po i fliste kështu komisari i saj!!

Dhimitra ngriu dhe ndjeu zemrën që i bëri lëmsh rrahjet.

“Gjykoje Mita këtë mendimin tim! Unë do iki, do të shkoj me divizionin dhe nuk do të kemi më rast të rrimë e të bisedojmë si sot, prandaj sa të jemi këtu në Përmet gjyko me qetësi. Pastaj më thuaj po ose jo”.

Tukun ajo e kishte parë dhe takuar shumë herë, madje në një rast, kur qe e sëmurë, ai e kishte hipur në kalin e tij.

Ai ishte i bardhë, shumë i bukur. Komisari nuk i hipte kurrë. E përdorte vetëm për të ndihmuar të plagosurit. Doemos që simpati për të kishte, fshehurazi, edhe pse kishin një diferencë prej 12 vitesh.

“Kemi dalë në mal sepse kryesore kemi luftën, të çlirojmë vendin, vazhdoi të fliste Tuk Jakova, por kjo nuk do të thotë gjë. Nuk ka gjë më të bukur Mita që edhe shokun e luftës ta kesh edhe shok jete. Prandaj ndjenjat nuk mund t’i ndalojë as lufta, po të kemi fat e të shpëtojmë. Ne nuk do t’i trembemi luftës, do të luftojmë, madje të mos e kursejmë veten”.

Pastaj vazhdoi: “Veten në luftë të mos e kursesh, sidomos kur e ke armikun përballë. Ai i armatosur, ti e armatosur. Por një këshillë të jap. Kur të bëhen pushkatimet, kurrë të mos marrësh pjesë! Nuk ka gjë më të ulët se të marrësh pjesë në një pushkatim, pavarësisht se ai dënohet me gjyq. Ke para një njeri të paarmatosur, pa asnjë forcë për t’u mbrojtur, kurse ti e ke në dorë. Mos merr pjesë kurrë!” Tuk Jakova që përsququr lehtësisht në fytyrë, por përpiqej me shumë mund të mos e bezdiste me vështrimin e tij, i cili tashmë ishte prej një të shumëdashuruari.

“Kështu pra, përsëriti, ne do të luftojmë, sepse këtë kemi detyrën kryesore, por s’ka më e bukur se shokun e luftës ta kesh edhe shok jete”.

“Nuk kam çfarë mendohem, Tuk”, foli menjëherë Mita.

“Po ta jap fjalën që tani, shqiptoi fort, edhe unë e kam menduar këtë dashuri, por nuk e kam shkuar ndër mend kurrë që unë Mita, një partizane e thjeshtë, do bëhesha shoqja e jetës e komisarit të brigadës. Prandaj unë nuk kam çfarë mendohem më. Të jap fjalën!” U ngritën në këmbë.

Tuku e mori afër dhe e puthi në ballë.

Aq shumë u trondit Mita, sa duke dalë, në vend të gjente shkallët për të zbritur, hyri në dhomën ngjitur ku një grua po gatuante.

Shkoi menjëherë tek familja ku kishin bazën dhe rrinte bashkë me të motrën. Sa ra në shtrat i hipi një temperaturë e lartë. Plot dyzetë.

Atë natë të 24 majit 1944, nëpër kllapi temperature, Dhimitra Jakovës i dilte para sysh, si vegim, fytyra e të vëllait, Petros.

Të dy kishin diferencë të madhe moshe, sepse i ati, emigrant në SHBA, kthehej rrallë në shtëpi dhe shtatzënitë e nënës qenë me shumë vite të largëta nga njëri-tjetri. Kështu Petro, pasi kishte kryer studimet për agronomi në Greqi dhe Mita që fare e vogël, u bë për të një mësues.

Njeri me karakter të mrekullueshëm, pas vdekjes së të atit që Dhimitrën e la nëntë vjeçe, ai e rriti atë shpirtërisht, mbi të gjitha i nguliti parimet e mirësjelljes në shoqëri.

Kështu kur ajo që pesëmbëdhjetë mote jete ai ishte njeriu i vetëm të cilit i pati premtuar se do t'ia thoshte të parit emrin e të dashurit të zemrës.

Por nuk e kishte mbajtur dot fjalën. Ishte magjepsur nga Tuk Jakova dhe e pati pranuar pa u këshilluar me të vëllanë. Kur ta mësonte këtë gjë çfarë do të thoshte Petro: pati vepruar drejt apo gabueshëm?

Ndërkaq të motrës, Dhorës, edhe pse e kishte aty, hë për hë nuk i tha gjë. I hapi rrugë vuajtjes së saj shumë të madhe ato çaste.



## **Vetëm sa përkëdhelën duart e njëri-tjetrit**

Në paraditen e 25 majit 1944 Tuk Jakova, ndërsa qenë provat e përgjithshme të korit të Brigadës së Parë, pa atje Dhorën, por jo Mitën.

E pyeti.

“Është e sëmurë, iu përgjigj e motra, ka shumë temperaturë”.

“Mirë, kur të shkosh në bazë të më thuash se do të vij edhe unë”.

Vajti ta shihte. Në bishtat e shamisë së kuqe të hedhur në qafë, për t'i lidhur fjongo, Tuku kishte vendosur një unazë. Ajo për një çast, si t'i dërgonte mesazh Mitës, vezulloi.

Ndërkaq plaka e shtëpisë ku rrinin, sapo e pa të porsaardhurin, thirri duke përplasur pëllëmbët: “Po kush është ajo lum nëne që të paska bërë ty!”

Tuk Jakova qe i gjatë, biond, me sy bojëqielli. “Kam ardhur nënë të shikoj këtë partizanen, tha ky me humor, sepse jam si gjysmë doktori”.

Kështu Mita e harroi temperaturën dhe u ngrit në këmbë. Në mbrëmje qe në kor, tashmë në shfaqjen zyrtare të koncertit për Kongresin e Përmetit. Këndoï solo edhe me kitarë.

“Pas koncertit do të takohemi”, pothuaj i pëshpëriti ai.

Të nesërmen Brigada e Parë do të ikte, për t'u gjendur menjëherë dhe drejtpërdrejtë në operacionin gjerman të qershorit.

Tuku do të largohet nga Përmeti dy ditë më pas. Megjithatë në mbrëmjen e 25 majit ndenjën bashkë vetëm sa kapën me përkëdheli duart e njëri-tjetrit.

## Shpirti që e vranë

Në letrën e 1 qershorit 1958 dërguar Tukut në Burgun e Vjetër të Tiranës ajo në fund të saj e nënshkruan “E jotja, Mita”.

Më sipër i pati thënë: “Në mbrëmje dolëm pak shëtitje dhe pastaj u ulëm në park po në atë vend ku ndejtëm të dy disa ditë para se të ndaheshim, te ajo banka afër lumit, të kujtohet? Që kur ke shkuar ti unë kam ndejtur atje vetëm dy herë. Është e tepërt të të shkruaj se sa shumë të kemi kujtuar sot, unë, fëmijët. Bujana sidomos. Ajo në drekë nguli këmbë duke thënë se dua të di se ku është Babi? Si nuk i mbaroi punët akoma? Pse nuk ka të tjerë që të bëjnë punën e tij? Dhe se po ta dinin ata q’ë mbajnë atje se sa shumë na ka marrë malli, do ta nisnin për në shtëpi me njëherë etj., etj.. ndërsa Niku dhe Gimi vështronin herë Bujanën, here mua në mënyrë kuptimplote. Ato nuk zëmërohen që unë e gënjej Bujanën (megjithëse gënjeshtren e dënojnë) përkundrazi, në këtë rast, donin të ishin në vend të saj”.

Në 15 qershor bashkë me letrën e të ëmës shkruan edhe Bujana: “Ajde shpejt! Më ka marrë malli shumë. Të shikoj në ëndërr. Kur të vish ti do të bëjmë një bakllava”.

Në 24 korrik 1958 në letrën e Mitas janë edhe këto radhë: “Sa herë vjen data 24 ndjej se më shtohet malli; “Çështja e konfiskimit të plaçkave këtu mori fund. Më morën vetëm 2 kolltukët, dy komodinat, 2 qilima dhe radion”.

Në 18 gusht: “Shumë i dashur Tuk. Gjithë ditën e 15 gushtit kam qenë zhytur në kujtimet e brigadës 1-rë. Duke kujtuar marshimet, luftrat, jetën në brigadë mua më duall

parasysh si në film njohja jonë, miqësija, dita e fejesës, takimet, çdo gjë e dashur dhe e shtrenjtë që ne jetuam si partizanë!”

Dita e fillimit të shkollës, 1 shtator 1958: “Asgjë s’ju bëra të re, por kur u veshën dukeshin sikur i kishin të gjitha të reja.

Po e nis nga Bujana, për të cilën kjo ditë ishte e shënuar mbasi ajo u bë nxënëse e kl. I-rë.

Bujanën e veshi me të gjitha ato që veshi Vjosa në kl. I-rë. Këtë propozim ma bëri Vjosa. Kërkuam nëpër rraqet e shtëpisë dhe gjetëm fustanin bojë qielli të qëndisur me të bardhë (Ty nuk të kujtohen këto).

E lamë, e pastruam, e rregullova pak (mbasi për trup i rrinte tamam) dhe kur u hekuros dukej krejt i ri. Gjithashtu i rregullova sandalet e bardha që i kishe sjellë Vjosës nga Hungaria, çorape bojë qielli, përparësen e bardhë, kordele të bardhë, flokët bukle dhe kur u vesh të kishe qejf ta shikoje.

Vjosës i rregullova përparësen e zezë me pulla dhe jakë të bardhë që kishte që vjet, por i ishte zvogëluar pak, asaj i bleva vetëm një palë kordele bojë rozë.

Dukeshe mjaft e rritur dhe tamam nxënëse shkolle. Agimi dhe Besnikun i veshi me bluza të bardha dhe pantallona blu të shkurtra. Bluzat ishin ato...

Në mëngjes secili i kishte në një karrige të veçantë, rrobat, sandalet, çantën e librave dhe fletoreve...filluam të vishemi. Vjosa dukej shumë e gëzuar. Bujana jo dhe aq, megjithëse, duhej të ishte ndryshe.

Vjosës nuk iu durua dhe i tha: “Po ti xhan pse s’dukesh e gëzuar, unë kur shkova në kl. I-rë s’më zuri gjumi”.

E çuditshme është Bujana. Unë e dua shumë atë se ajo të don shumë ty dhe e ndjen aq shumë mungesën tënde. Ja si iu përgjegj ajo: “Por kur shkove ti, Agimi dhe Niku në kl I-rë Babi ishte në shtëpi, tashti që po shkoj unë Babi s’është në

shtëpi, prandaj s'jam shumë e gëzuar" dhe menjëherë ju mbushën sytë me lot.

Kjo përgjigje e saj shkaktoi menjëherë heshtje.

Vjosa s'iu përgjegj. Mua m'u bë një lak në fyt, por e mbajta. I thashë se babi megjithëse nuk është në shtëpi sot mendjen e ka tek ti se e di që do të shkosh në shkollë për herën e parë dhe ai e di se ti do të bëhesh shumë e mirë e do të marrësh nota të mira.

Në atë çast e mbajta veten, por tashti që po të shkruaj ty, lotët po m'i bëjnë me mjegull shkronjat".

Në 2 dhjetor: "Vjosa dhe Bujana dolën të tabelën e nderit për rezultatet shumë të mira dhe sjellje shembullore".

Në 21 shkurt 1959, të shkruara nga Vjosa: "Gjithnjë të kemi në gojë e gjithnjë të shohim në ëndërr. Kur rrimë darkave tek zjarri themi sikur tani të hapet dera e të hyjë Babi mbrenda. Të gjithë do t'i hidhemi në qafë e do ta puthim fort e sidomos Mami!"

Në 27 shkurt 1959, Mita shpjegon: "Më duket se s'të kam shkruajtur, që nga fundi i dhjetorit më muarën të gjitha dekoratat dhe certifikatat tënde".

8 mars: "Xhan i Mitës! Sa shumë më merr malli për ty. E pse ta shkruaj këtë!"

I biri, Agimi: "I dashur Babi. Jam mirë me shëndet e me mësim. Më ka marrë malli shumë për ty. Mami më ka blerë një çift pëllumbash. Kafazin ja u bëra vetë. Këto ditë pres të më pjellin. Kujdesem shumë për ta dhe i kam shumë qejf. Kur ju hedh bukë menjëherë vinë tek unë. Mashkulli ta kafshon gishtin. Fluturojnë në çati. Të puth me mall".

Besniku: "Mami thotë që unë jam bërë i mirë".

Bujana: "Unë tani e mbarova abetaren e mora këndimin dhe librin e gjuhës. Tashti do të shkruaj letra ty. Më ka marrë malli shumë të të puth faqen dhe të ma shposh me mjekër".

Vjosa: “Meqë sot është 8 marsi, ditëlindja ime dhe festa e gruas, vendosëm të tre të të shkruajmë”.

12 prill 1959, Bujana: “Unë e kam marrë dëftesën, prapë pesa i kisha. Por megjithatë Mami më ka thënë edhe më shumë mëso. Unë e ndihmoj Mamin në punët e shtëpisë. Një ditë Mami kishte ikur në punë, dhe unë ndeza zjarrin dhe zjeva fasulet. Kur lan Mami rrobat unë i mbledh. Vjosa më mëson si t’i bëj punët...”

Besniku: “Ty Babi të kishte pëlqyer shkrimi dhe sjellja ime. Unë dua të bëhem edhe më i mirë, po nga një herë s’bëhem dot”.

22 prill 1959 Mita i rrëfen Tukut për Vjosën: “E mira kryesore që duket tek ajo, është dëshira e madhe për studim dhe kujdesi i veçantë që tregon për përgatitjen e detyrave shkollore... Më pëlqejnë shumë hartimet e saj. Ato nuk janë të thjeshta. Kanë mjaft përmbajtje të bukur, të lidhura mendimet, nga ana gjuhësore mjaft të mira dhe çka më çudit më shumë është imagjinata e saj...Profesori gjithmonë ja lexon hartimet para klasës...nga ana tjetër i pëlqen shumë puna. Edhe kjo një cilësi e mirë, i gjen punë vetes. Mund të të duket çudi, po unë gati të gjitha arnimet ja kam lënë Vjosës. Ka shumë durim dhe bën punë të pastër. I pëlqen të qëndisë, të bëjë triko, punë shtëpie etj. I pëlqen shumë të lexojë e të diskutojë. Shpesh të kujton ty... Ndjen nevojën të dalë shëtitje, po dëshëron me njerëzit e saj. Kënaqet kur del me mua. Më zë për krahu dhe s’pushon së pyeturi”.

Në 24 maj 1959, Mita shkruan: “15 vjet nga dita e fejesës dhe 2 vjet që je larg familjes”.

## **“Gjithë jetën të kam dashur për karakterin tënd”**

Kështu i shkruante Mita në 13 korrik 1959, ndërsa Tuk Jakova që në burg.

Patën jetuar bashkë vetëm 13 vite.

Nuk patën bërë dot martesë, por vetëm një foto në 29 nëntor 1944 në Tiranën e çliruar.

Nëna e Tukut që prej këtij çasti dhe më pas, kur do ta pyesnin se çfarë paje i kishte sjellë nusja korçare, do ta kishte gati përgjigjen: “Po besa më ka prurë boll, më ka prurë pajë pushkën dhe gjerdanin”.

Ishte 8 marsi 1946 dhe ajo priste çdo ditë të lindte fëmija. Tuku do të shkonte në festën e Gruas dhe i tha “Mita, në qoftë se ke vajzë, bëje sot që të ketë festën e saj!”

Kur erdhi nga mbledhja ajo ishte në lindje, në një nga dhomat e shtëpisë, ku pati ardhur edhe doktori.

Vjehrra priste djalë dhe kur pa se që vajzë, u mërzit.

Kur hyri Tuku dhe e pa të voglën të mbështjellë e me faqe të plota (lindi 3.8 kg), me të në krahë shkoi tek pasqyra dhe e përkëdheli me fjalët “Molla e babit!”

I vunë emrin Vjosa në kujtim të 24 majit të tyre, kur i dhanë fjalën njëri-tjetrit në Përmetin buzë lumit Vjosa.

“Kam shumë dëshirë të shkruaj dhe Mami më thotë që të vazhdoj letërsi”, i përcillte dëshirën e saj të atit në verë të vitit 1959, kur ajo që vetëm 13 vjeçe.

“Si thua ti babi?”

Por kjo ëndërr për t’u bërë shkrimtare iu rrënua që atë vit. Shumë e brishtë në ndjenjat e saj goditjen e parë të rëndë psikologjike, si të që shkarkim elektrik me fuqinë shkatërruese të një rrufeje, e mori në 22 qershor 1959, kur

në takimin në burg me të atin nuk e lejuan Tukun t'i puthte fëmijët.

As t'i prekte me dorë.

Ata rrinin bashkë me Mitan dhe ai qëndronin pas dy portave të hekurta larg nga njëra-tjetra.

Vjosa ishte mekur në lot.

Goditja e dytë, edhe më paralizuese se e para, që lajmi për vdekjen e të atit.

Letra e fundit e Tukut daton më 20 gusht dhe në të shkruan se ishte mirë me shëndet. I uronte edhe ditëlindjen të birit, Agimit, e cila që në 15 shtator.

Kjo letër do të mbërrinte në Berat, por nuk do ta kishte këtë fat ajo që një ditë më pas, në 21 gusht, do të niste Mita.

Në datën 26 Tuk Jakova do të ndërronte jetë në spitalin e burgut.

Diçka të ligë ajo e kishte parandjerë kur në 20 gusht pati shkuar në burg për ta takuar sipas datës së paracaktuar dhe e kishin kthyer mbrapsht, duke i thënë se i shoqi ishte mirë, por që shtruar në spital (!?).

Nuk i pranuan as ushqimet, çfarë e vuri në alarm për sigurinë e jetës së të shoqit.

Shumë vite pas 1990-tës, mjeku që ishte marrë me çastet e fundit të Tuk Jakovës, pati pohuar se kur e thirrën çdo gjë kishte marrë fund. Pacienti që me temperaturë të lartë dhe e vetmja që mundi të bënte ishte t'i lehtësonte agoninë. Sipas Gjergj Titanit, ish-partizan, më pas i persekutuar politik dhe shkrimtar e përkthyes, në parathënien për librin "Letërkëmbim i dhimbshëm", ngul këmbë se "Kur ministri i brendshëm i asaj kohe Kadri Hazbiu më 26 gusht 1959 ka raportuar në mënyrë të pazakontë para mbledhjes së Byrosë Politike se Tuk Jakova kishte vdekur në spitalin burg nga apandisiti akut, Enver Hoxha ishte bërë bishë duke i rënë tavolinës me grushte e duke bërtitur: kjo është

a pafalshme, të vdesë njeriu në mes të Tiranës. Do të përgjigjeni sepse do të na akuzojnë se e kemi vrarë vetë ne etj., etj..”

Ish-i persekutuari politik nga diktatura, Nikollë Zagorjani, nga Velipoja e Shkodrës, pas rënies së regjimit do t'i dorëzonte Agim Jakovës një dëshmi të shkruar në letër dhe po ashtu të regjistruar me zërin e tij dukshëm të singertë.

Ajo ndodhet edhe në arkivën time.

Është një dokument me një fuqi besueshmërie të jashtëzakonshme.

Nikolla kishte ndodhur të ishte në dhomën e Spitalit Civil Nr.2, ku pas operacionit shumë të vonuar të apandesitit, qe shtruar edhe Tuku.

Tregon ai: “Të burgosurin e prunë në dhomë dhe e vendosën në krevatin ngjitur me mua, pranë dritares. Ishte me vetëdije, por narkoza nuk i kishte dalë akoma. Dritarja qe me hekura. Përveç rojës tek dera, me ardhjen e këtij të burgosuri u shtua një roje edhe tek dritarja.

Në mëngjes iu afrova, e përshëndeta dhe u prezantova. Më tha: “Jam Tuk Jakova”.

I sëmuri dalëngadalë përmirësohej.

Fiziku i tij gjigand i kalitur mbi 2 vjet mbijetesë në mal, në natyrë, triumfoi”.

Më pas: “Mëngjesin e 26 gushtit 1959 roja lajmëron Tukun, se e kërkonin dhe duhej ta shoqëronte.

Si kaloi goxha kohë Tuku u kthye.

Dridhej pak.

E pyeta: “Çka kje kjo Tuk?”

Kishin ardh nja dy shokë nga Ministria e Brendshme me më takue”.

“Çka të thanë?”

“Bamë bajagi muhabet. U interesunë për familjen, pastaj kujtuem kohën e luftës e muhabete të tjera”.

“A të qitnë gja?”



“Po”.

“Çka?”

“Konjak”.

“A pive?”

“Po, piva”.

“Të kan myt, mor qyqar!”

“Jo, mor, shokët me ma ba këtë punë? Ata më thanë në fillim...”Tuk a nuk po pin një gotë me ne?”

Kundërshtova, jam i operuem, thaç, e kam frikë se më ban dam”.

“Ke të drejtë, si të dush”, më thanë.

Vazhdume muhabetin. Ata kishin mush gotat e tyre dhe pjesës së metun në shishe i kishin futur për tapë një gotë përmys.

Ngjit me to ishte një tabake e vogël me 2-3 gota të tjera përmys.

Shakat dhe muhabeti kjen të amla. Dikur mora gotën, e kqyra me kujdes. Kje e pastër. E musha dhe kadal-kadal e piva.

Si piva gotën, pas pak u çunë. Më uruan me urimet ma të mira dhe u damë”.

Pak momente më vonë, siç rrëfen Nikolla Zagorjani, Tukut i nisi temperatura e lartë dhe i shpërthyen dhimbje të mëdha në bark. Për t’ja lehtësuar ai e mbante në prehër dhe i shtrëngonte barkun”.

Kur shkoi një çast në banjë aty Tukut i ra të fikët. Infermierët që erdhën i bënë gjëlpëra qetësuese, temperatura filloi të ulej, por nisi të fliste përçart....

## **Elektroshok**

Goditja e tretë ndaj ndjenjave dhe shpirtit të brishtë të Vjosës, vajzës që kishte emrin e vendit të dashurisë së prindërve, erdhi kur i ndodhi që një mësues nga Tirana i emëruar në gjimnazin e Beratit, një djalë simpatik dhe i butë, t'i shprehte dashurinë.

Ky shkoi edhe tek Mita dhe ia tha dëshirën.

Ajo e paralajmëroi të mendohej mirë, sepse qenë të dënuar politikë. Iu lut të mos u hapte telashe të reja, sepse boll deri atëherë kishte pasur, por tjetri nuk u tërhoq.

Nga gëzimi Vjosa përlotej dhe u thoshte shoqeve: “Kush është më e lumtur se unë!”

Veç vendosmëria e djaloshit mësues nuk zgjati shumë. Doli Letra e Hapur e Enver Hoxhës, lufta e klasave u acarua skajshëm. I trembur shkoi në degën e Punëve të Brendshme të Beratit për të pyetur si të vepronte dhe ata nuk ja kishin kursyer përgjigjen: “Nuk na pyete kur e more, pse na pyet tani?”

Pas kësaj gjendja psikike e Vjosës hyri në paqëndrueshmëri të plotë. I vëllai, Agimi, tregon një skenë, kur e transportuar nga Berati në një sallë të spitalit civil të Tiranës, ajo vajzë e bukur si ëngjëlli doli totalisht e shkatërruar, pothuaj pa ndjenja, me kokën varur si t'i binte nga çasti në çast prej trupit.

I kishin bërë elektroshok.

## **Goditja e katërt**

Përfundimtarja, ishte kur Vjosa që studente, e drejtë e fituar falë një letre që Mita ia kishte bërë komandantit të saj të luftës partizane, Mehmet Shehut dhe ndërhyrjes së tij pozitive.

Autoritetet e fakultetit i bënë asaj një presion terrorizues, duke e kërcënuar se jashtë po e priste për ta burgosur një “Gaz” i Ministrisë së Brendshme dhe se po ashtu do ta mbyllnin në një çmendinë.

Rrebeshin politik mbi të e kishin derdhur për një arsye fare të panevojshme: Vjosës i kishte humbur (apo ia patën vjedhur) fletën e votimit, një pusullkë e rëndomtë, që mund të ribëhej.

## **“Ku të të fsheh që të mos të gjejë vdekja?”**

Tani Vjosa engjëllore është psikologjikisht shumë e dëmtuar, por që falë dashurisë të familjes së saj, të së ëmës sa ishte gjallë, tashmë perkujdesit të familjes së Agimit, me të cilin bashkëjeton, si edhe dashurisë së motrës Bujana, është në jetë.

Por vëllai i madh, Besniku, mungon. Në 28 qershor 1994 ai vdiq në një aksident në Brixhport të SHBA. Ishte 45 vjeç, aq sa qe edhe i ati kur e nda nga jeta.

Ndërkaq Vjosa e sjell përherë nëpër mend të ëmën, duke vështruar divanin e vogël ku ajo rrinte dhe ku kur qe ende në gjendje të shkruante, Mitas i qe drejtuar me fjalët: “Ku të të fsheh që të mos të gjejë vdekja?”

## **Zonjë e nderuar...**

Mita Jakova ruante nën jastëk, si një gjë shumë të çmuar, një letër që i kishte dërguar dorazi një njeri, të cilin ajo nuk e ka pati parë kurrë.

Quhej Dhimitri Bibolli dhe letra e shkruar në kompjuter daton nëntor 2001.

Thuhet në të: “E nderuar zonjë. Është e pamundur që një qenie njerëzore që ende i ruan të kthjellëta sytë, veshët e shpirtin në këto kohë garimesh drejt hiçit, të mos i shprehë ndjenjat e tij ndaj një monumenti ngritur në përkujtim të tragjizmit, dashurisë, mjerimit e qëndresës, siç është letërkëmbimi mes jush dhe bashkëshortit tuaj të ndjerë. Nuk guxoj të komentoj llahtarën e jetëve tuaja, veç nuk mund ta ndrydh gulçin që ndjej për të shprehur mbresat e mija faqe kësaj madhështie të hedhur në letër. Mes ditarëve dhe epistolarëve të vyer që ndodhen në kujtesën e botës dhe që unë kam lexuar, letërkëmbimi juaj është i pari për nga tronditja që të shkakton me pleksjen e ndjenjave dhe pashterrjen e informacionit mbi natyrën njerëzore.

Nuk mund të mos shpreh, se sa e vogël më është dukur vetja dhe sa cinikë një pjesë e mirë e njerëzve që njoh, kur i përball me sflitjen e trupave dhe shpirtrave tuaj e për më tepër me madhështinë e dashurisë tuaj bashkëshortore e prindërore.

As nuk mundem të përfytyroj nga cilat vise të panjohura vjen kjo fuqi e juaja për të shpërfillur deri në indiferencë të gjitha tmerret që vetëm njeriu mund t'i gatujë. Jam i sigurt, Zonjë, se shpesh ia keni bërë vetes pyetjen “Pse të më ndodhin pikërisht mua të gjitha këto?”

Nuk besoj se keni gjetur një përgjigje, por unë ju them se për çfarëdo arsye të jeni martirizuar, gjithçka në jetën tuaj vetëm ju ka nderuar dhe lumtëruar...”

## **Ringjallja**

Rilindjen e Mitas e ka siguruar mbesa e Bujanës, Hana. Në një urim për ditëlindjen e stërgjyshes bashkë me vizatimin e degëve të lulëzuara të një kumbulle, ajo i ka shkruar: “E dashur Nëna Mita, mos u sëmur më të lutem se kam nevojë për fjalët e tua ëmbla”. Edhe Tuku tashmë ka rilindur brenda familjes së tij. Stërnipi, djali i djalit të Agimit, me emrin Pjetër, siç edhe qe emri i vërtetë i Tukut, është një krijesë tërësisht si stërgjyshi.